



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS
MINISTRIA E MJEDISIT DHE
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRY OF ENVIRONMENT
AND SPATIAL PLANNING

VLADA KOSOVA
MINISTARSTVO SREDINE I
PROSTORNOG PLANIRANJA

**LIGJI
PËR MBROJTJEN E NATYRËS**

PRISHTINË, QERSHOR 2004

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të Rregullores nr.2001/9 të dt.25 maj 2001 Për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, veçanërisht nenet 5.1 (f), 5.7, 9.1 .26 (a), 9.3.3, 11.2 dhe tutje;

Duke parë nevojën për të sjellë standarde mbi mjedisin në Kosovë në harmoni me ato të Bashkimit Europian;

Të dedikuar pas qëllimit për të mundësuar një mjedis të shëndetshëm në rritje për popullin e Kosovës;

Duke patur parasysh së vënja e standardeve të tilla dhe krijimi i një mjedisi të tillë duhet të formohet në mënyrë që të jetë konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe që Kosova të mund të përballojë harxhimet e tilla; dhe,

Me qëllim krijimin e bazës së kornizës ligjore që do të

- (i) mundësojë një ruajtje efektive të biodiversitetit dhe peizazheve, duke marrë parasysh kërkesat ekonomike, sociale, kulturore dhe lokale;
- (ii) të mundësojë një mjedis të shëndetshëm në rritje gjatë sjelljes graduale të standardeve për ruajtjen e natyrës dhe parimeve të Bashkësisë Evropiane;
- (iii) sigurojë që për krijimin e një mjedisi të tillë mund të përballohen shpenzimet dhe është konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik,
- (iv) krijojë kompetencat dhe detyrimet e autoriteteve publike që janë përgjegjëse për sjelljen dhe fuqizimin gradual të rregullave dhe standardeve lidhur me ruajtjen e natyrës;
- (v) të caktojë të drejtat dhe detyrat e personave dhe ndërmarrjeve që preken nga aktivitetet e ruajtjes së natyrës apo të personave dhe ndërmarrjeve që disponojnë interesa në promovimin e ruajtjes së natyrës në Kosovë;

Nxjerr Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, si vijon:

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Lënda e rregullimit

1. Ky ligj përcakton sistemin për mbrojtjen e natyrës në territorin e Kosovës.
2. Vlerat e natyrës të përcaktuara në pajtim me këtë ligj janë me interes për Kosovën dhe gëzojnë mbrojtje të posaçme.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

1. Ky ligj krijon bazën ligjore për mbrojtjen e natyrës, zhvillimin e qëndrueshëm të saj dhe veçanërisht:
 - a) mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës dhe burimeve të përtëritshme të natyrës;

- b) rivitalizimin e territoreve të dëmtuara të natyrës ose pjesëve të saj dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- c) ruajtjen dhe restaurimin e baraspeshës ekologjike në natyrë;
- d) vendosjen e sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim, për mbrojtjen e natyrës;
- e) realizimin e qëllimeve, të përcaktuara në politikat e mbrojtjes së natyrës;
- f) zvogëlimin e shfrytëzimit tejmase dhe rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe i habitateve të tyre.
- g) e drejta për informim publik dhe pjesëmarrje të publikut në lëmin e mbrojtjes së natyrës;
- h) sigurimim e së drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë.
- i) sigurimin e biodiversitetit përmes ruajtjes së habitateve të rëndësishme natyrore dhe llojeve me rëndësi të florës dhe faunës në statusin e favorshëm të ruajtjes.
- j) sjelljen e standardeve të Kosovës në harmoni me ato të Bashkimit Evropian sipas seksionit 5.7 të Kornizës Kushtetuese për Vetqeverisje të Përkohshme në Kosovë.

Neni 3

Ligjet e posaçme

1. Ruajtja dhe mbrojtja e tokës, ujit, ajrit, pyjeve dhe përbërësve të tjerë të natyrës, rregullohen me ligje të posaçme.
2. Zbatohen dispozitat e këtij ligji, nëse sigurojnë shkallë më të lartë të mbrojtjes, se dispozitat e ligjeve të posaçme.
3. Dispozitat e këtij ligji ose ato të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit do të zbatohen për ruajtjen dhe mbrojtjen e elementeve të trashëgimisë së natyrës që nuk janë rregulluar me ligj të posaçëm.

Neni 4

Zbatim i ligjit

1. Ky ligj zbatohet në territorin e Kosovës për të gjithë personat juridik, fizik dhe asociacionet të cilat janë bartës të të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga ky ligj.
2. Ky ligj nuk zbatohet në rastet e evitimit të rrezikut të drejtpërdrejtë për jetën apo shëndetin e njeriut apo pasurisë, shpëtimit të njerëzve ose pasurisë si dhe kryerjes së aktiviteteve për mbrojtjen e Kosovës.
3. Dispozitat nga paragrafi 2 i këtij neni, zbatohen vetëm gjatë kohës, sa zgjasin rrethanat e përcaktuara.

II. PËRKUFIZIMET

Neni 5

Definimet

Shprehjet e përdorura në këtë ligj, kanë këto kuptime:

Natyrë – diversiteti i tërësishëm peizazhor dhe biologjik.

Biodiversitet – diversitet gjenetik i llojeve dhe eko-sistemeve.

Dëmtimi i natyrës - dëmtimi i natyrës ose i komponenteve të saj, në drejtim të çfarëdo ndryshimi, të ndotjes apo shfrytëzimit, deri në shkallën e pamundësisë për përfitje dhe kthim në gjendjen e mëparshme me ndikime negative në florën dhe faunën.

Rrjeti ekologjik – sistem koherent i kompozuar nga të gjitha zonat e caktuara të mbrojtjes që përmbajnë tipet e habiteteve dhe habitatet e llojeve të mbrojtura me këtë Ligj, të cilat funksionojnë për të mundësuar tipet e habitateve natyrore dhe habitaveve të llojeve që të mirëmbahen nëse kërkohet, të rikthehen në gjendje të mëparshme të statusit të ruajtjes në formën e tyre natyrore.

Fosilet – tërësi të ruajtura, pjesë ose gjurmë të organizmave të vdekur dhe aktiviteteve të tyre jetësor.

Habitatet natyrore - territore tokësore ose ujore të cilat dallojnë për nga karakteristikat gjeografike, abiotike dhe biotike pa marrë parasysh se a janë plotësisht natyrorë apo përafërsisht-natyrore.

Habitatet e llojeve – mjedis i definuar nga faktorë specifik biotik dhe abiotik, në të cilat lloje të veçanta të bimeve dhe shtazëve, jetojnë në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor.

Interpretimi i Përgjithshëm – çdo term që përdoret në këtë Ligj dhe në të Direktivën e BE-së (79/409) apo Direktivën e Habiteteve (92/43) do të ketë kuptimin që i është dhënë në Direktivat e BE-së, përveç nëse ekziston një qëllim tjetër i qartë.

Libri i Kuq - regjistër i llojeve të rrezikuara të bimëve, kërpurdhëve dhe shtazëve, i radhitur sipas kategorive të rrezikueshmërisë, duke iu referuar anekseve relevante të Direktivave të BE-së 79/409 dhe 92/43.

Llojet me rëndësi - lloje me rëndësi të veçantë për Kosovën dhe llojet e përmendura në Direktivën e BE-së për Habitatet (92/43) ose në Direktivën e BE-së për Shpezët e egra (79/409) dhe anekset relevante dhe të cilat janë të rrezikuara, të ndieshme dhe kërkojnë përkujdesje të veçantë. Llojet tjera mund të identifikohen si të rëndësishme brenda territorit të Kosovës nëse janë:

- i) të rrezikuara
- ii) të ndieshme, d.m.th. besohet se do të bëhen të ndieshme apo të rrezikuara në një të ardhme të afërt nëse situata zgjat.
- iii) Të rralla, d.m.th. me populacione të vogla të cilat nuk janë në gjendjen e tanishme të rrezikuara apo të ndieshme por ndodhen në rrezik.
- iv) Endemike dhe kërkojnë vëmendje të veçantë për shkak të natyrës së tyre specifike dhe/apo ndikimit të mundshëm të eksploatimit të tyre në statusin e ruajtjes së tyre.

Llojet - secili lloj, nën-lloj apo populacion gjeografik, veçanërisht secili lloj shtazëve dhe bimëve, të gjalla apo vdekura, çdo pjesë që lehtësisht njihet apo çdo pjesë e formuar nga to.

Llojet me rëndësi të habitateve natyrore – tipe të habitateve natyrore brenda territorit të Kosovës të cilat janë:

- i) në rrezik nga zhdukja në formën e tyre natyrore
- ii) kanë një shkallë të vogël natyrore
- iii) paraqesin shembuj të shkëlqyeshëm të karakteristikave tipike të një habitati vendor duke iu referuar Direktivës së BE-së 92/43.

Ruajtja e natyrës – seri e masave të domosdoshme për mirëmbajtjen dhe për rikthimin e habitateve natyrore dhe populacioneve të llojeve të florës dhe faunës në status të favorshëm të ruajtjes siç referohet me këtë Ligj.

Mineralet - elemente homogjene kimike ose kombinime amorfe, të kristalizuara ose amorfe, të strukturës ose formës së caktuar. Në kuptim të këtij ligji mineralet nuk janë lëndë minerare.

Ministria – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor themeluar me Rregulloren 2001/19.

Ministri - Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor themeluar me Rregulloren 2001/19.

Organizmat e modifikuara gjenetikisht (OMGJ) – organizma (bimët, shtazët, mikroorganizmat dhe pjesët e tyre), të krijuara përmes inxhinjeringut gjenetik, respektivisht modifikimeve gjenetike, siç definohet me Direktivën e BE-së 2001/18.

Peisazhi - hapësirë e caktuar veçorinë e të cilit janë rezultat i veprimit dhe ndërveprimit, të faktorëve natyrorë ose njeriut.

Pëlqimi mjedisor - dokument i cili vendos pëlqimin ose refuzimin e projektit.

Përbërësit e natyrës – elemente të natyrës, siç janë flora dhe fauna, organizmat e gjallë dhe ekosistemi i tyre (biodiversiteti), toka, uji, ajri, peisazhi, mjedisi jetësor artificial, të mirat natyrore dhe veprimi reciprok i këtyre elementeve.

Statusi i Ruajtjes së Habitave Natyrore – tërësia e ndikimeve në habitate natyrore dhe në llojet specifike të cilat mund të ndikojnë në shpërndarjen e tyre natyrore afatgjatë, strukturën, funksionet si dhe mbijetesën afatgjatë të llojeve të tyre tipike. Statusi i ruajtjes së habitatit natyror do të konsiderohet si i favorshëm kur:

- i) shtrirja e saj natyrore dhe zonat të cilat i përfshinë në atë shtrirje janë stabile apo në rritje.
- ii) Struktura dhe funksionet specifike të cilat janë të domosdoshme për mirëmbajtjen ekzistojnë dhe do të vazhdojnë të ekzistojnë në një të ardhme të parashikuar, dhe
- iii) Statusi i ruajtjes së llojeve të tyre specifike është i favorshëm siç referohet me këtë Ligj.

Statusi i ruajtjes së llojeve – tërësia e ndikimeve përmes veprimit në lloje të cilat mund të ndikojnë në shpërndarjen afatgjatë dhe begatinë e populacioneve të tyre brenda territorit. Statusi i ruajtjes do të konsiderohet i favorshëm, nëse:

- i) të dhënat e dinamikës së populacionit, lidhur me llojet ndikojnë në mbajtjen e tyre në baza afatgjata, si një komponentë i dukshëm, i habitateve të tyre natyrore,
- ii) shtrirja natyrore e llojeve nuk është zvogëluar dhe as nuk duket të zvogëlohet për një të ardhme të afërt, dhe
- iii) ekziston dhe me siguri, do të vazhdon të mbetet një habitat i madh dhe i mjaftueshëm, për mirëmbajtjen e populacioneve të tyre, në baza afatgjate.

Shfrytëzimi i qëndrueshëm - shfrytëzimi i elementeve të natyrës në mënyrën dhe shkallën e mosshtrjes së aftësive të tyre ripërtitëse ose shkaktimin e zvogëlimit të resurseve natyrore dhe llojshmërive biologjike dhe peisazhore dhe me këtë ta mbajë potencialin e tyre, nga zanafilla për përmbushjen e kërkesave dhe nevojave, të brezave të sotëm dhe të ardhshëm.

Shkalla e I - e mbrojtjes - aplikohet në zona, me veçori natyrore të jashtëzakonshme që kanë të bëjnë me dukuri natyrore, lloje të rralla dhe të rrezikuara të bimëve, shtazëve dhe tipeve të habitateve. Kjo zonë gëzon karakterin e mbrojtjes strikte.

Shkalla e II - e mbrojtjes - aplikohet në zonën që karakterizohet me ekosisteme, vlera peisazhore dhe vlera të tjera të natyrës në të cilat, mund të ushtrohet veprimtari e cila nuk është në kundërshtim me destinimin e mbrojtjes.

Shkalla e III - e mbrojtjes - aplikohet në zonë të destinuar për ndërtimin e objekteve për rekreacion, turizëm dhe nevojat e banorëve në zona të mbrojtura.

Shpellë – zgavër/hapësirë nëntokësore më e gjatë se 5 metra e krijuar në kushte natyrore, nën veprimin e faktorëve me origjinë jo organike.

Të mirat e natyrës – të gjithë përbërësit e natyrës që njeriu i shfrytëzon për qëllime ekonomike. Të mirat e natyrës mund të jenë të papërtëritshme (lëndët minerale) dhe të përtëritshme (të mirat biologjike, uji, toka e përtëritshme).

Vlerat e natyrës – pjesë të natyrës të cilat meritojnë mbrojtje të posaçme, për të ruajtur larminë biologjike dhe peisazhore, për shkak të ndjeshmërisë së tyre ose interesit shkencor, kulturor, estetik, arsimor dhe ekonomik.

Vlerat e mbrojtura të natyrës – vlera të natyrës, të shpallura nga organet e përcaktuara me këtë ligj dhe të regjistruara në regjistrin për vlerat e mbrojtura të natyrës.

Zonë – një hapësirë e definuar gjeografike që është e kufizuar në mënyrë të qartë.

Zhvillim i qëndrueshëm - sistem i kushteve dhe aktiviteteve shoqërore-ekonomike që mbrojnë llojet e egra dhe mjedisin jetësor artificial, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, shfrytëzimin e resurseve natyrore, në mënyrë të arsyeshme, për ruajtjen e ekosistemeve, cilësisë së jetës dhe llojshmërisë biologjike dhe kulturore në baza të periudha të gjata kohore brenda aspektit të ekosistemit si tërësi.

Projekt – çdo aktivitet, operim, zhvillim dhe ndryshim i propozuar në shfrytëzimin e tokës apo zgjatje të rëndësishme dhe ndërrime të tjera (të konsideruara nga autoritetet kompetente si ndërrime substanciale në instalime apo ndryshime në operacione të cilat mund të kenë ndikime të mëdha negative në shëndetin e njerëzve dhe mjedis) të cilat num mund të implementohen pa pëlqim mjedisor apo leje mjedisore.

III. PARIMET THEMELORE

Neni 6

Autoritetet publike, me rastin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, respektojnë parimet në vijim:

a) Parimi i bashkëpunimit

Të gjithë personat juridik dhe fizik, janë të detyruar t'a ruajnë natyrën, të bashkëpunojnë në pengimin e veprimtarive që rrezikojnë ose dëmtojnë natyrën, për zbutjen e dëmtimeve, eliminimin e pasojave të dëmtimeve dhe ripërtitjen e natyrës së dëmtuar.

b) Parimi i qëndrueshmërisë

Shfrytëzimi i llojeve të egra (bimore dhe shtazore), mineraleve dhe territoreve me karakteristika natyrore ose përafërsisht natyrore, mund të bëhet vetëm deri në nivelin që nuk cënon larminë biologjike dhe peisazhore.

c) Parimi i integritetit

Interesat e ruajtjes së natyrës, merren parasysh me rastin e përcaktimit të strategjisë për zhvillim ekonomik, planifikim hapësinor dhe gjatë aplikimit të masave të caktuara nga organet qeveritare.

ç) Parimi dëmtuesi, shfrytëzuesi i natyrës paguan

Dëmtuesi dhe shfrytëzuesi detyrohen t'i paguajnë shpenzimet, taksat etj., për dëmtimin ose shfrytëzimin e natyrës apo të resurseve natyrore.

d) Parimi i arsimimit dhe vetëdijësimit publik

Ndërgjegjësimi për aplikimin e këtij ligji dhe të akteve tjera ligjore për ruajtjen e natyrës arrihet përmes arsimimit dhe vetëdijësimit publik.

dh) Parimi i përgjegjësisë

Organet menaxhuese, publiku dhe subjektet ekonomike, janë të detyruar që veçanërisht, të kujdesen për: zhvillimin e qëndrueshëm gjatë realizimit të veprimtarive të shfrytëzimit

ekonomik të resurseve të përtëritshme dhe të papërtëritshme natyrore; pengimin, zvogëlimin e dëmeve dhe rreziqeve për shëndetin e njeriut.

e) Parimi i menaxhimit efektiv për mbrojtjen e natyrës

Organet e pushtetit qendror dhe lokal, do të sigurojnë dhe koordinojnë qeverisje efektive për mbrojtjen e natyrës.

IV. DOKUMENTET E MBROJTJES SË NATYRËS

Neni 7

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen e Natyrës

1. Dokumentet e mbrojtjes së natyrës përfshijnë: Strategjinë, Planin e veprimit dhe programin për mbrojtjen e natyrës.

2. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen e Natyrës përmbajnë, detyrat dhe politikën e mbrojtjes së natyrës si dhe ofrojnë mbikqyrje dhe mbrojtje të pjesëve tjera të rëndësishme, të trashigimisë natyrore.

3. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen e Natyrës nga paragrafi 2 i këtij neni veçanërisht përmbajnë:

- a) përshkrimin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura të natyrës dhe veprimtarive të cilat janë me rëndësi, për ruajtjen e biodiversitetit,
- b) kërkesat e përgjithshme si dhe detyrimet sektoriale dhe ndërsektoriale, për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura të natyrës, peizazheve dhe vlerave të natyrës,
- c) propozimin e masave për shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës,
- d) detyrat afatmesme dhe afatgjate të mbrojtjes dhe ruajtjes së llojeve të mbrojtura, mineraleve, zonave të mbrojtura të natyrës dhe caktimit të zonave të reja për mbrojtje,
- e) detyrat afatmesme dhe afatgjate, për vendosjen dhe mirëmbajtjen e rrejtit ekologjik dhe të korridoreve ekologjike,
- f) detyrat afatmesme dhe afatgjate, për mirëmbajtjen e territoreve të mjedisit jetësor të ndjeshëm dhe të ekosistemeve,
- g) sistemin e kushteve dhe parimeve të rëndësishme nga pikat a,b,c,d dhe të këtij paragrafi,
- h) programet afatmesme dhe afatgjatë për kërkime, zhvillime, detyra demonstruese dhe arsimore në popullarizimin e mbrojtjes së natyrës dhe ruajtjeve të saj,
- i) planifikimin e burimeve të financimit,
- j) parimet për vendosjen dhe funksionimin e sistemeve monitoruese, grumbullimin e të dhënave, regjistrimin dhe vlerësimin e peisazheve, llojeve, mineraleve dhe të territoreve, me karakteristika natyrore ose përafërsisht natyrore.

4. Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtjen e Natyrës e aprovon Kuvendi i Kosovës me propozim të Qeverisë. Kërkesat e Qeverisë respektohen në hartimin e strategjive sektoriale.

Neni 8

Programet për mbrojtjen e natyrës

1. Komuna nxjerr programin për mbrojtjen e natyrës, përmbajtja e të cilit duhet të jetë në pajtim me paragrafin 2 të nenit 7.

2. Programet përmbajnë masat e detajizuara të mbrojtjes që dalin nga ky ligj.

V. ORGANET PËRGJEGJËSE PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Neni 9

1. Punët administrative dhe profesionale i kryen Ministria dhe zyra e administratës komunale për mbrojtjen e natyrës.
2. Punët profesionale në mbrojtjen e natyrës për Kosovën, i kryen Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (këtu e tutje: Instituti) në kuadër të AKMM-së si vijon:
 - a. mbledhja dhe përpunimi i shënimeve lidhur me mbrojtjen e natyrës,
 - b. hartimi i bazave të caktuara për llojet e bimëve, shtazëve, kërpudhave, biotopeve, ekosistemeve dhe peisazheve,
 - c. monitorimi e gjendjes të larmisë biologjike dhe peisazhore dhe propozimi i masave për mbrojtjen e natyrës,
 - d. kryerja e analizave statistikore, përmbledhja e rezultateve dhe hartimi i raporteve për gjendjen e mbrojtjes së natyrës,
 - e. zbatimi i akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës.
3. Mjetet për kryerjen e veprimtarisë së institutit, të përcaktuara me këtë ligj, sigurohen nga buxheti i Kosovës dhe nga burimet tjera, në pajtim me ligj.

Neni 10

1. Komunat detyrohen, që në pajtim me këtë ligj, Strategjinë dhe Planin e Veprimit për mbrojtjen e natyrës dhe dokumentet për planifikim hapësinor që:
 - a. të kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peisazhore në territorin e vet;
 - b. të shpallin zonat e mbrojtura që janë kompetencë e tyre;
 - c. të sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura që janë në kompetencën e tyre;
 - d. të marrin pjesë në procedurën e shpalljes së zonave të cilat i shpall Kuvendi dhe Qeveria;
 - e. të marrin pjesë në hartimin e planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura që janë në kompetencën e tyre;
 - f. të mbajnë regjistrin për shënimet që janë me rëndësi për mbrojtjen e natyrës;
 - g. të informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e tyre dhe masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e saj;
 - h. të kryejnë edhe punë të tjera, të përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitat e nxerra prej tij.
2. Mjetet për kryerjen e veprimtarisë në mbrojtjen e natyrës, sigurohen nga komunat përmes bugjetit të tyre dhe nga burimet tjera, në pajtim me ligj.

VI. MASAT E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Neni 11

Mbrojtja e peizazheve

1. Mbrojtja e peizazheve ka për qëllim mbrojtjen e:

- a) karakteristikave të ekosistemeve dhe llojeve të rralla e të rrezikuara,
- b) veçorive të peizazheve të rrezikuara,
- c) vlerave rekreative të peizazheve.

2. Ministri me akt nënligjor përcakton mënyrën dhe kushtet e mbrojtjes së peizazheve jashtë territoreve të mbrojtura, mënyrën e hartimit, llojet e planeve dhe projekteve për mbrojtjen e peizazheve.

3. Me akt, sipas paragrafit 2 të këtij neni, do të përcaktohet:

- a) procedura dhe marrja e pëlqimit mjedisor për veprimtari në territoret e peizazheve,
- b) përmbajtja dhe forma e raporteve të cilët i paraqet bartësi i hartimit i planeve dhe projekteve organit kompetent për masat e ndërmarrura me qëllim të pengimit të ndikimeve negative tek peizazhet,
- c) veprimet e ndaluara në territoret e mbrojtura.

4. Pëlqimi mjedisor jipet nëse konstatohet, se plani dhe projekti, nuk dëmton statusin e favorizuar të mbrojtjes së llojeve të mbrojtura apo të rrezikuara të habitateve dhe peizazheve.

5. Ndikimi negativ, sipas paragrafit 4 të këtij neni, ekziston nëse, plani ose projekti mund të shkaktojë:

- a) efekte negative tek një numër i konsiderueshëm i llojeve bimore, kërpudhave dhe llojeve shtazore të rrezikuara, të rralla ose të ndjeshme, si pasojë e veprimeve negative,
- b) nëse pritet çrregullim i madh në relacionet ose veprimet reciproke në mes të llojeve bimore dhe shtazore dhe faktorëve të tyre natyrorë, biotik ose abiotik (gjeologjike, klimatike, tokësore, ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor etj.) në ekosisteme apo pjesë të tyre.

6. Përgjithësisht, projekti i propozuar i cili normalisht të ndalohej sipas paragrafeve 3,4, dhe 5 të këtij neni, mund të lejohet nëse konsiderohet i nevojshëm duke patur parasysh interesin publik përfshirë edhe arsyet e natyrës ekonomike dhe sociale.

- a. autoriteti kompetent do të ndërmarr masa adekuate për pengimin e keqësimit të habitateve natyrore dhe habitateve të llojeve në zona të tilla, sikurse edhe pengimin e shqetësimit të llojeve për të cilat janë caktuar zonat, përderisa një shqetësim i tillë, mund të jetë i rëndësishëm sa i përket qëllimeve të Ligjit;
- b. secili plan apo projekt që ka efekt të rëndësishëm për menaxhimin e zonës, qoftë individualisht apo në kombinim me plane të tjera apo projekte, do të nënshtrohet vlerësimeve përkatëse, lidhur me ndikimet e tyre dhe autoriteti kompetent do të pajtohet lidhur me planin apo projektin, vetëm pas të sigurohet që nuk do të ketë ndikim keqësues në integritetin e zones së caktuar;
- c. përkundër vlerësimeve negative të implikimeve të zones, plani apo projekti, duhet medoemos të ekzekutohet për arsye imperative të interesit publik, përfshirë edhe ato lidhur me shëndetin njerëzor, sigurinë publike dhe ato të natyrës sociale dhe

ekonomike, autoriteti kompetent do të kërkojë të gjitha masat kompenzuese të domosdoshme, për të siguruar koherencën e ekosistemit të caktuar;

7. Me aktin nënligjor nga paragrafi 2 i këtij neni do të parashihet se cilat interesa publike, kanë rëndësi më të madhe, se sa rëndësia e mbrojtjes së natyrës.

Neni 12

Mbrojtja e llojeve të florës dhe faunës së egër

1. Dispozitat e këtij ligji, zbatohen për të gjitha llojet e bimëve dhe shtazëve të egra, në secilën fazë të zhvillimit, në secilën formë dhe gjendje, përveç përjashtimeve të parapara me akt nënligjor.

2. Ndalohet shfarosja ose dëmtimi me qëllim, shpërdorimi ose shfrytëzimi i tepruar i bimëve të egra të pambrojtura, duke përfshirë edhe listën e llojeve të rëndësishme, me përjashtim të atyre nga paragrafit 1 i këtij neni.

3. Ndalohet shqetësimi, ndjekja ose vrasja e shtazëve të egra, duke përfshirë edhe listën e llojeve të rëndësishme, zhvendosja, dëmtimi ose shkatërrimi i qëllimshëm i vendeve të riprodhimit ose i zonave të pushimit, nëse për këtë nuk ekzistojnë arsye të veçanta.

4. Llojet e egra të cilat nuk janë përfshirë, sipas paragrafit 1, 2 dhe 3, mbrohen me Libër të Kuq.

Neni 13

Libri i Kuq

1. Ministri nxjerr aktin nënligjor me të cilën përcaktohen llojet me rëndësi dhe llojet e habitateve të cilat gëzojnë mbrojtje të veçantë mbi bazën e të cilit hartohet Libri i Kuq. Akti nënligjor përcakton përmbajtjen, formën dhe detaje të tjera të Librit të Kuq.

2. Mbrojtja e llojeve dhe llojeve të habitateve të specifikuar në Librin e Kuq do të realizohet përmes shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës dhe duke përcaktuar kushtet për menaxhimin e tyre.

3. Publiku ka të drejtë të informohet, për shkaqet e përfshirjes së çdo lloji a habitati të tyre në Librin e Kuq dhe masat e përdorura të cilat zbatohen, për përmirësimin e gjendjes së llojeve dhe habitateve nga Libri i Kuq.

Neni 14

Mbrojtja e habitateve natyrore

1. Ruajtja e biodiversitetit do të realizohet përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së bimëve, kërpudhave, shtazëve dhe habitateve të tyre.

2. Ruajtja e habitateve natyrore nga Libri i Kuq bëhet me shpalljen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura.

Neni 15

Mineralet dhe fosilet

1. Mineralet dhe fosilet janë pronë e Kosovës.

2. Ndalohet shkatërrimi i pajustificuar i mineraleve dhe fosileve, dëmtimi i vendgjetjeve të tyre, përveç kur ekziston interesi publik.

3. Për zbulimin e mineraleve dhe fosileve, me rëndësi të posaçme për shkak të vëllimit, raritit, përbërjes apo vetive tjera të tyre, lajmërohet Ministria, në afatin prej 15 ditësh, nga dita e zbulimit.

4. Në propozim të AKMM-së, ministri, me akt të veçantë, përcakton se cilat minerale dhe fosile paraqesin vlera të mbrojtura të natyrës.
5. Në rastin nga paragrafi 3 i këtij neni, zbuluesi është i detyruar fillimisht t'i ofrojë shitjen Ministrisë.

VII. MASAT E VEÇANTA PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Neni 16

Zonat e mbrojtura të natyrës

1. Zonë e mbrojtur e natyrës është zonë e shpallur me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes së biodiversitetit, peisazheve, karakteristikave natyrore dhe trashëgimisë kulturore dhe për ofrimin e menaxhimit efektiv përmes mjeteve juridike dhe mjeteve të tjera.

2. Ministria ka për detyrë që, pas konsultimit me AKMM, të pregatis një list të zonave të mbrojtura të natyrës në bazë të kriterëve të vlerësimit të vendeve të përcaktuara me Aneksin III të Direktivës mbi Habitatet të BE-së dhe informatat tjera të rëndësishme. Ministria duhet të përcaktoj për secilën zonë llojin me rëndësi të habitatit dhe llojeve.

3. Zona të mbrojtura sipas këtij Ligji janë:

- a) zona e mbrojtur e rezervateve strikte natyrore, për qëllime shkencore apo me qëllim të mbrojtjes së llojeve të egra (Kategoria e I e IUCN-së);
- b) parku kombëtar i bazuar në qëllimet e mbrojtjes së ekosistemeve dhe për qëllimeve rekreative (kategoria e II e IUCN-së);
- c) monumenti natyror i shpallur për qëllime të ruajtjes së vetive specifike natyrore (Kategoria e III e IUCN-së);
- d) rezervati natyror i menaxhuar, zona e menaxhimit të habitateve dhe llojeve (Kategoria IV e IUCN-së);
- e) peisazhi i mbrojtur me qëllim të ruajtjes të peisazheve tokësore (Kategoria e V e IUCN-së);

4. Krahas nenit 7, paragrafi 3 (h) dhe (j) të këtij Ligji, AKMM do të kryej mbikqyrjen të statusit të ruajtjes të habiteteve të rëndësishme natyrore dhe llojeve për qëllime të përgatitjes dhe nxjerrjes së zonave të propozuara të mbrojtjes së natyrës.

5. Ministria do të njohtoj secilin pronar apo posedues të tokës, e cila është përfshirë në listën e propozuar të zonave të mbrojtura të natyrës, dhe secilin bartës të së drejtës së mineraleve që ka të bëjë me atë tokë, mbi propozimin për përfshirjen e tokës në atë list. Një njohtim i tillë do të ofroj detaje sa i përket:

- i) kufinj të saktë të zonës së propozuar;
- ii) llojet e habitaveve natyrore dhe llojeve që i përfshin lista e propozuar e mbrojtjes së natyrës;
- iii) gjendja ekzistuese e mbrojtjes së llojeve dhe habiteteve natyrore të zonës së propozuar;
- iv) projektet të cilat Ministria i konsideron se mund të kenë efekte negative në zonë;
- v) procedurat për ankesë nga personat e afektuar lidhur me listën e propozuar.

6. Personit të cilit i është dorëzuar njoftimi lidhur me përfshirjen e tokës në listën e propozuar të zonave të mbrojtjes së natyrës mund të bëjë ankesë me shkrim duke bashkangjitur një

arsyetim të bazuar shkencor (në bazë të kritereve nga Aneksi III, i Direktivës mbi Habitatet të BE-së dhe informatat të tjera relevante) brenda periudhës prej tre muajve në mënyrën e specifikuar me njoftim.

7. Ministri përmes aktit nënligjor mund të specifikoj formën e njoftimit dhe procedurën e ankesës lidhur me kundërshtimet për përfshirjen e tokës në zonën e mbrojtjes së natyrës.

8. Kuvendi i Kosovës, Qeveria dhe autoritetet komunale janë autoritete kompetente për shpalljen e zonave të mbrojtura sipas kategorizimit të propozuar nga AKMM.

9. Autoriteti relevant, 12 muaj pas botimit të listës së propozuar të zonave të mbrojtjes së natyrës, do të shpall zonat e mbrojtura të natyrës, duke marrë parasysh në këtë aspekt edhe këshillat e AKKM-së.

10. Pas përfshirjes së hapësirës në listën e propozuar të zonave të mbrojtjes së natyrës, ndalohet çfardo shkatërrimi i gjendjes së mbrojtur të secilës pjesë të asaj hapësire.

Neni 17

Menaxhimi i zonave të mbrojtura të natyrës

1. Menaxhimi i zonave të mbrojtura të natyrës bëhet për qëllime:

- a) të kërkimeve shkencore;
- b) të mbrojtjes së llojeve të egra, habitateve dhe ekosistemeve;
- c) të ruajtjes së diversitetit gjenetik dhe të llojeve;
- d) të përkujdesjes së shërbimeve mjedisore;
- e) të mbrojtjes së veçorive specifike të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- f) të turizmit dhe rekreacionit;
- g) arsimimit dhe sigurimit të qasjes së publikut në informim;
- h) përdorimit të qëndrueshëm të resurseve nga ekosistemet natyrore;
- i) ruajtja e veçorive kulturore dhe tradicionale;

2. Për çdo kategori të zonave të mbrojtura të natyrës mund të përcaktohet shkalla e I, II dhe III e mbrojtjes.

3. Statusi i zonave të mbrojtura të natyrës do të definohet me aktet nënligjore për zonat e mbrojtura të natyrës në pajtim me Ligjin të cilat do të përcaktojnë shkallën e mbrojtjes dhe parimet e menaxhimit sipas secilës kategori.

Neni 18

Rezervati strikt i natyrës

1. Rezervat strikt i natyrës është territori tokësor ose ujor që disponon me ekosisteme të shquara me veti gjeologjike dhe lloje i destinuar para së gjithash për kërkime shkencore dhe monitorim mjedisor.

2. Qëllimet e menaxhimit me rezervatet strikte të natyrës janë:

- a. ruajtja e habitateve, ekosistemeve dhe llojeve nga shqetësimet
- b. përkujdesja e resurseve gjenetike në gjendje dinamike dhe evolutive
- c. përkujdesja e proceseve të themeluara ekologjike
- d. ruajtja e vetive strukturore peisazhore apo relieveve shkëmbore
- e. ruajtja e mostrave të mjedisit natyror për studime shkencore
- f. arsimimi dhe monitorimi mjedisor

- g. ulja e shqetësimeve përmes planifikimit me kujdes të zbatimit të hulumtimeve dhe aktiviteteve të tjera
- h. kufizimi i qasjes së publikut për informim.

3. Shpalljen e rezervatit strikt të natyrës e bën Qeveria.

4. Për hulumtime shkencore dhe realizimin e vizitave për qëllime të arsimit në rezervatin strikt të natyrës nevojitet leja e Ministrisë.

5. Për rezervatet strikte të natyrës vlen shkalla e I-rë e mbrojtjes.

Neni 19

Parku kombëtar

1. Park kombëtar është territor natyror i cili shpallet për:

- a) mbrojtjen e tërësisë ekologjike, të një apo më shumë ekosistemeve, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- b) përjashtimin e shfrytëzimeve apo uzurpimet me qëllim të ndryshimit dhe dëmtimit të natyrës;
- c) sigurimin e bazave për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative, kulturore dhe mundësi vizitash, në pajtim me parimet e mbrojtjes së mjedisit.

2. Qëllimet e menaxhimit të parkut kombëtar janë:

- a) mbrojtja e territoreve natyrore me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative dhe turistike;
- b) ruajtja e gjendjes burimore, të shembujve reprezentativ të zonave fiziografike, bashkësive biotike, resurseve gjenetike dhe llojeve për sigurimin e biodiversitetit dhe të stabilitetit ekologjik;
- c) siguri i shfrytëzimit në aspektin inspirues, shkencor, arsimor, kulturor dhe rekreativ që ta mbajë zonën në gjendjen natyrore ose afërsisht natyrore;
- d) përjashtimi i shfrytëzimeve ose i vizitave të cilat mund të shkaktojnë ndryshime dhe dëmtime të natyrës;
- e) mbajtja e veçorive ekologjike, gjeomorfologjike dhe estetike për të cilat territori është shpallur i mbrojtur.

3. Parku kombëtar shpallet nga Kuvendi i Kosovës.

Neni 20

Monumentet natyrore

1. Monumenti natyror është territor që përmban një ose më shumë veçori specifike natyrore dhe kulturore me vlera të posaçme ose unike, për shkaqe rariteti, vetishë natyrore, reprezentative, rekreative dhe estetike ose vlera të posaçme kulturore.

2. Monumentet natyrore mund të jenë me karakter:

- a) gjeologjik (paleontologjik, mineralogjik, hidrogeologjik, gjeologjik, sedimentet)
- b) gjeomorfologjik (shpella, humnera, shkëmbinj);
- c) hidrologjik (ujërrjedha, ujëvara, liqene);
- d) botanik (ekzemplarët e rrallë të botës bimore);

3. Monumentet e natyrës shpallen nga komuna, përveç atyre me rëndësi të posaçme për Kosovën të cilat shpallen nga Qeveria, në propozim të AKMM.

4. Qëllimet e menaxhimit të monumentve natyrore janë:

- a) mbrojtja dhe ruajtja e vetive të qëndrueshme natyrore me rëndësi të posaçme, cilësive unike, dhe vlerave inspiruese;
- b) ofrimin e mundësive për kërkime shkencore, arsimore, interpretuese dhe vlerësuese nga publiku;
- c) ndalimi dhe pengimi i shfrytëzimeve dhe vizitave të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime;
- d) ofrimi i beneficioneve aq sa është e lejueshme për popullatën e cila jeton në ato territore, në pajtim me qëllimet menaxhuese.

Neni 21

Shpellat

1. Shpallja dhe mbrojtja e shpellave bëhet me vendim të Qeverisë.

2. Hyrja në shpella, eksplorimi dhe studimi i shpellave, bëhet me leje të Ministrisë e cila jepet në propozim të autoriteteve lokale përkatëse, institucioneve shkencore dhe organizatave të specializuara jofitimprurëse, në përputhje me rekomandimet e tyre.

3. Zbulimi i shpellave dhe rezultatet e eksplorimit të tyre i bëhen të njohura, me raporte të hollësishme, Ministrisë. Ministria, sipas nevojës u dërgon kopje të raportit institucioneve shkencore, organizatave të interesuara jofitimprurëse si dhe autoriteteve lokale përkatëse. Eksploruësve u njihet dhe u sigurohet e drejta e autorësisë së zbulimit.

4. Shpellat mund të vizitohen, të përdoren për qëllime turistike ose të tjera, vetëm pasi të jenë përshtatur për këto veprimtari, me autorizim dhe nën mbikëqyrjen e AKMM, strukturave përkatëse të turizmit dhe pushtetit lokal. Eksplorimi, hyrjet e autorizuara dhe çdo përdorim i shpellave, duhet të sigurojë mbrojtjen dhe pastërtinë e tyre, ruajtjen e mikroklimës, regjimit ujor, ekosistemeve, të tipareve gjeologjike dhe gjeomorfologjike, të gjetjeve paleontologjike e arkeologjike dhe të gjallesave.

5. Qeveria me akt nënligjor përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat, të drejtat dhe detyrimet për dhënien e shpellave në përdorim. Përgatitja dhe përdorimi i tyre mund të bëhen nga subjekte publike ose private, të pajisura me pëlqim mjedisor.

6. Përfundimisht, Qeveria me akt nënligjor, sipas propozimit të ministrit dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal, mund të ndaloj shfrytëzimin e shpellave nëse konstatohet se vlerat e tyre rrezikohen.

Neni 22

Zona e menaxhimit të habitateve dhe llojeve

1. Zona e menaxhuar e habitateve dhe llojeve (rezervat natyror i menaxhuar) është zonë tokësore ose ujore që i nënshtrohet intervenimeve aktive për qëllime të menaxhimit për të siguruar përkujdesjen e habitateve dhe plotësimin e kërkesave specifike të llojeve.

2. Qëllimet e menaxhimit të zonës së menaxhuar të habitateve dhe llojeve janë:

- a) të sigurojë dhe mirëmbajë kushtet e domosdoshme të habitateve për mbrojtjen e llojeve të veçanta, grupeve të llojeve, bashkësive biotike apo veçorive fizike të mjedisit në të cilat kërkohet një veprim i veçantë për menaxhim human;
- b) të lehtësojë kërkimet shkencore dhe monitorimin mjedisor, si aktivitete primare të lidhura me menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve;
- c) të zhvillojë zonat specifike për arsimim publik dhe vlerësim të karakteristikave të habitateve si dhe për menaxhimin me llojet e egra;
- d) të ndalojë dhe parandalojë shfrytëzimin ose uzurpimin që është në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes,
- e) të ofrojë beneficione, aq sa është e mundëshme, për popullatën që jeton në ato territore, në pajtim me qëllimet e mbrojtjes.

3. Zona e menaxhuar e habitateve dhe llojeve shpallet nga Qeveria e Kosovës.

Neni 23

Peisazhi i mbrojtur

1. Peisazhi i mbrojtur është territor tokësor, ujqor në të cilin bashkëveprimi i njeriut dhe natyrës, për kohë të gjatë, kanë krijuar hapësirë karakteristike, me vlera të theksuara estetike, ekologjike dhe kulturore, e shpeshherë me biodiversitet të theksuar. Ruajtja e integritetit të këtij bashkëveprimi tradicional është esencial për mbrojtjen, përkujdesjen dhe zhvillimin e asaj zone.

2. Qëllimet e menaxhimit me peisazhin e mbrojtur janë:

- a) mbajtja e stabilitetit në veprimet reciproke të natyrës dhe njeriut me mbrojtjen e peisazheve tokësore, ujore dhe shfrytëzimit tradicional të tokave, ndërtimeve, si dhe manifestimeve shoqërore dhe kulturore;
- b) përkrahja e mënyrës së jetesës dhe aktiviteteve ekonomike të cilat janë në harmoni me natyrën;
- c) ruajtja e larmisë së peisazheve, habitateve të llojeve të ngjashme dhe ekosistemeve;
- d) të ndalojë dhe parandalojë shfrytëzimin apo uzurpimin e tokave dhe ndërmarrja e aktiviteteve që nuk janë në pajtim me qëllimet e mbrojtjes.
- e) krijimin e mundësive për rekreacion dhe turizëm të cilat i përgjigjen kategorive të zonave;
- f) nxitja e aktiviteteve shkencore dhe arsimore për të mirën afatgjatë të popullsisë si dhe shtimin e mbështetjes publike për mbrojtjen e atyre zonave;
- g) ofrimi i beneficioneve dhe kontributit në mirëqenien e komunitetit përmes sigurimit të prodhimeve natyrore (siç janë: prodhimet ekologjike të pyllit dhe peshkimi) dhe shërbimet (siç janë: uji i pastër dhe të ardhurat nga turizmi).

3. Peisazhi i mbrojtur shpallet nga Qeveria e Kosovës.

Neni 24

Pjesëmarrja e publikut në caktimin e zonave të mbrojtura të natyrës

1. Përveç përgjegjësisë së Ministrisë për iniciimin e shpalljes së zonave të mbrojtura të natyrës, çdo person fizik dhe juridik mund të inicioj procedurën për shpalljen e zonave të tilla. AKMM do të shqyrtoj në mënyrë profesionale çdo propozim për shpalljen e zonave të mbrojtjes së natyrës në bazë të cilës Ministria do të propozoj apo do të kundërshtoj propozimin për shpalljen e hapësirës së caktuar si zonë të mbrojtur të natyrës sipas procedurës së përcaktuar me nenin 16.

Neni 25

Mbrojtja e përkohshme

1. Për zonat për të cilat zhvillohet procedura për vënie nën mbrojtje, vendosen nën mbrojtje të përkohshme nga dita e përfshirjes së tyre në listën e zonave të mbrojtura të natyrës.
2. Zonat e përcaktuara si vlera natyrore me planin hapësinor vihen nën mbrojtje të përkohëshme prej ditës së hyrjes në fuqi të planit.
3. Procedura e shpalljes së zonave natyrore nga paragrafi 2 i këtij neni duhet të kryhet në afat prej 2 vjetësh.
4. Nëse nuk është filluar procedura në afatin nga paragrafi 3 i këtij neni, mbrojtja e përkohshme e zonës të determinuar përmes dokumenteve mbi planifikimin hapësinor si zona të mbrojtura do të pushon të jenë valide.
5. Për kohën sa zgjat mbrojtja e përkohëshme e zonës, aplikohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 26

1. Regjistri qendror i zonave të mbrojtura të natyrës, llojeve të mbrojtura dhe habitateve natyrore, mineraleve dhe fosileve mbahet nga AKMM.
2. Regjistrimi i zonave të mbrojtura të natyrës dhe fshirja nga regjistri bëhet në bazë të aktit për shpallje, përkatsisht me aktin për ndërprerjen e mbrojtjes.
3. Ministri përmes aktit nënligjor rregullon formën dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit qendror për zonat e mbrojtura të natyrës.

Neni 27

1. Kufinjtë e zonave të mbrojtura të natyrës shënohen me shenja.
2. Shënimin e zonës së mbrojtur të natyrës e bënë AKMM në afat prej 6 muaj nga dita e shpalljes së zonës.
3. Mënyra e shënimit të zonës së mbrojtur të natyrës përcaktohet nga Ministri me akt nënligjor.

Neni 28

Sistemi i informimit dhe vetëdijësimi publik

1. Vendosja, menaxhimi dhe funksionimi i sistemit informativ për mbrojtjen dhe monitorimin e natyrës do të jenë pjesë e Sistemit Informativ për Mbrojtjen e Mjedisit sipas nenit 37 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit 2003/09.
2. Sipas paragrafit 1 të këtij neni do të kryhet regjistrimi, përcjellja, grumbullimi dhe analizimi i të dhënave, fakteve dhe informatave tjera relevante për gjendjen dhe shfrytëzimin e natyrës, masave të ndërmarrura nga organet drejtuese, autoritetet dhe organizatat tjera.
3. Ministri i paraqet raport Qeverisë për gjendjen e natyrës së paku një herë në vit.

4. Publikut i sigurohet qasje e papenguar në informim për gjendjen e natyrës.

Neni 29

Qeverisja e zonave të mbrojtura të natyrës

1. Secili akt për shpalljen e zonave të mbrojtjes së natyrës do të përcaktoj qëllimet e menaxhimit dhe masat e veçanta për mbrojtjen e natyrës dhe teknikat të cilat do të aplikohen në zonën e mbrojtur të natyrës.

2. Pas nxjerrjes së aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës nxirret plani i posaçëm i menaxhimit për secilën zonë nga organi që e ka vënë zonën nën mbrojtje.

Neni 30

1. Autoritetin për qeverisjen me parkun kombëtar, monumentet e natyrës me rëndësi të veçantë dhe peisazheve të mbrojtura e themelon Qeveria.

2. Në propozim të autoritetit për menaxhim të parkut kombëtar dhe peisazhin e mbrojtur, ministri e rregullon me akt nënligjor, më të cilën rregullohet mbrojtja, përparimi dhe shfrytëzimi i parkut kombëtar dhe peisazhi i mbrojtur.

3. Autoritetin për qeverisjen e kategorive të tjera të mbrojtjes e themelon komuna sipas pëlqimit paraprak të Minsitrisë.

Neni 31

1. Planet e menaxhimit të çdo zone të mbrojtur të natyrës aprovohen nga Ministria për periudha të caktuara kohore.

2. Ministria me akt të veçantë përcakton përgatitjen, përmbajtjen dhe përcaktimin e masave të domosdoshme si dhe organin kompetent për zbatimin ose kontrollimin e masave të posaçme të menaxhimit për zonat e mbrojtura të natyrës.

Neni 32

Veprimtaritë dhe ndikimet e tyre në zonat e mbrojtura

1. Në pajtim me nenin 11, akti për shpalljen e zonës së mbrojtjes së natyrës përcakton ndalimet dhe kufizimet e veprimtarive apo projektet e lejuara brenda asaj zone për realizimin e qëllimeve të menaxhimit.

2. Në pajtim me nenin 11, Ministri mund të lejojë përjashtime nga ndalimet dhe kufizimet nga paragrafi 1 i këtij neni nëse veprimtaria e caktuar apo projekti i caktuar nuk paraqet ndikim negativ për qëllimet e menaxhimit apo arsyet e interesit publik, përfshirë arsyet ekonomike dhe sociale.

VIII. MBROJTJA E LLOJEVE TË EGRA

Neni 33

Flora e mbrojtur

1. Për llojet me rëndësi të florës të evidentuara në Librin e Kuq ndalohet:

- a) vjelja, shkulja me rrënjë, apo dëmtimi si dhe grumbullimi i tyre jashtë vëllimit të tyre natyror;

- b) mbajtja, transportimi, shitja, ndërrimi ose ofrimi për shitje i llojeve të egra, përveç atyre që në mënyrë të ligjshme janë marrë para implementimit të këtij Ligji.

2. Ndalesat nga paragrafi 1 i këtij neni përfshijnë të gjitha fazat e cikleve jetësore të bimëve.

3. Deri në nxerrjen e Librit të Kuq, Ministri me akt nënligjor përcakton listën e llojeve të florës për të cilat vlejné ndalesat nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 34

Fauna e mbrojtur

1. Për llojet e faunës të evidentuara në Librin e Kuq ndalohe:

- a) përvetësimi apo vrasja e qëllimshme;
- b) shqetësimi i qëllimshëm sidomos gjatë reprodukimit, gjumit dimëror dhe migrimit të tyre;
- c) shkatërrimi i qëllimshëm apo marrja e vezëve;
- d) heqja ose dëmtimi i qëllimshëm i çerdheve, stroullave dhe vendbanimeve të tyre;
- e) mbajtja, transportimi, shitja ose këmbimi i llojeve nga bota e egër, përveç atyre të cilat janë kryer para hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- f) veprimet të cilat mund të shkaktojnë zhdukje apo shqetësime të popullacionit të atyre llojeve.

2. Ministri, me akt nënligjor, përcakton rregullat përkatëse të nevojshme për mbrojtjen e llojeve të faunës nga Libri i Kuq.

3. Ndalesat nga paragrafi 1 pika a) dhe b) të këtij neni, kanë të bëjnë me të gjitha fazat e cikleve jetësore të shtazëve.

4. Deri në nxerrjen e Librit të Kuq, Ministri, me akt të veçantë, përcakton listën e llojeve të faunës për të cilat vlejné ndalesat nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 35

Përrjashtimet nga mbrojtja

1. Ne pajtim me nenin 11, Ministri, me akt të veçantë, mund të lejojë përrjashtime me kusht që këto përrjashtime të mos kenë pasojë negative në llojet me rëndësi.

- a) në interes të mbrojtjes së llojeve të florës dhe faunës dhe ruajtjen e habitateve natyrore;
- b) për pengimin e dëmeve të mëdha në kulturat bujqësore, në bagëti, në pyje, në peshkim, në ujëra dhe në format tjera të pronësisë;
- c) në interes të mbrojtjes së shëndetit publik dhe sigurisë publike apo për arsye të tjera të domosdoshme të interesit publik, përrfshirë ato të natyrës ekonomike dhe sociale dhe pasojat beneficuese të rëndësisë së veçantë për mjedisin;
- d) për qëllime të arsimit dhe kërkimeve, të ri-popullimit dhe ri-futjes së këtyre llojeve dhe për operimet e shumëzimit të cilat janë të nevojshme për këto qëllime, përrfshirë edhe promovimin e seleksionimit artificial të bimëve;
- e) për lejimin, në kushte të rrepta me bazë selektive dhe në shkallë të kufizuar, për marrjen ose ruajtjen e llojeve të caktuara dhe të rëndësishme në numër të kufizuar të specifikuar me akt nënligjor.

Neni 36

Futja e llojeve të reja ose të zhdukura

1. Për qëllime të mbajtjes së barazpeshës ekologjike, ndalohet futja e qëllimshme (introdukcionit) e llojeve të reja të florës dhe faunës të cilat nuk kanë prejardhje nga territori i Kosovës. Përfundimisht, Ministri me akt nënligjor mund të lejoj futjen e llojeve të reja nëse një gjë e tillë nuk ka pasoja negative për habitatet brenda vëllimit të tyre natyrorë ose për llojet e egra të florës dhe faunës.

2. Futja e sërishme (ri-introdukcionit) e bimëve dhe shtazëve të zhdukura në Kosovë, bëhet vetëm me pëlqimin paraprak të Ministrisë dhe Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 37

Organizmat e modifikuar gjenetikiisht

1. Për të penguar ndikimin negativ në ruajtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, duhet të sigurohen dhe zbatohen masat përkatëse të mbrojtjes për qëllime të sigurisë në importimin, transportimin, shfrytëzimin e kufizuar, futjen e qëllimshme në mjedis dhe tregtimin e organizmave të modifikuar gjenetikiisht (këtu e tutje: OMGJ).

2. Lejen për importim, transportim, përdorimin e kufizuar, futjen me qëllim në mjedis, lëshimin në treg të OMGJ-ve ose prodhimeve të cilat përmbajnë OMGJ e lëshon **Qeveria**.

3. Për ta përcjellur gjendjen dhe zhvillimin në lëmin e përdorimit të OMGJ-ve si dhe për ofrimin e ndihmës profesionale organeve kompetente të administratës, Qeveria themelon Këshillin Shkencor për shfrytëzimin e kufizuar, futjen në mjedis, ushqimin e ri dhe ushqimin për kafshë që përmban OMGJ.

4. Qeveria, me akt të veçantë, rregullon përbërjen, fushëveprimtarinë dhe mënyrën e punës së Këshillit Shkencor nga paragrafi 3 i këtij neni.

IX. MBIKËQYRJA

Neni 38

1. Mbiqëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxerrura në bazë të tij e bën Ministria.

2. Inspektimin e kryen inspektori për mbrojtjen e natyrës në kuadër të Inspektoratit Mjedisor.

3. Në zbatimin e mbiqëqyrjes inspektuese, inspektori i mbrojtjes së natyrës inspekton:

- a) gjendjen e statusit të ruajtjes natyrore të llojeve me rëndësi dhe llojeve të habitateve;
- b) shfrytëzimin resurseve të natyrës;
- c) zbatimin e planeve hapësinore të parqeve kombëtare (zonave të mbrojtjes së natyrës) dhe planet e shfrytëzimit të të mirave të natyrës në ato zona në pjesën që ka të bëjë me masat dhe kushtet e mbrojtjes së natyrës;
- d) zbatimin e planeve të menaxhimit;
- e) veprimet të cilat mund të shkaktojnë ndryshime dhe dëmtime të natyrës;
- f) zbatimin e mbrojtjes, ruajtjes dhe shfrytëzimit të drejtpërdrejtë të resurseve natyrore;
- g) zbatimin e masave të mbrojtjes së llojeve me rëndësi si dhe llojeve të tjera të vlerave të mbrojtura të natyrës;
- h) eksportimin, importimin dhe kalimin tranzit të llojeve me rëndësi nëse janë të kufizuara ose të ndaluara me dispozita ligjore;
- i) introdukcionin dhe reintrodukcionin i llojeve;

- j) informimin e publikut për gjendjen e natyrës;
- k) zbatimin e kushteve dhe masave të tjera të përcaktuara për mbrojtjen e biodiversitetit dhe peisazheve të përcaktuara me këtë Ligj dhe me aktet nënligjore të nxerra në bazë të tij;

X. FINANCIMI PËR MBROJTJEN E NATYRËS

Neni 39

1. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj mjetet sigurohen nga:

- a) Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, dhe
- b) Fondi për Mbrojtjen e Mjedisit (Ekofondi).

2. Mjetet nga paragrafi 1. pika a) të këtij neni, shfrytëzohen për largimin e pasojave të dëmshme të shkaktuara në natyrë nga personi i panjohur, kur nuk dihet shkaku i dëmit të bërë dhe në rastet kur është i domosdoshëm intervenimi urgjent për mbrojtjen e natyrës.

3. Mjetet nga paragrafi 1 pika b) të këtij neni përdoren për mbrojtjen e natyrës dhe për:

- a) realizimin e qëllimeve dhe detyrave të parapara me këtë ligj;
- b) hartimin e Strategjisë dhe planeve të përcaktuara me këtë ligj;
- c) zvogëlimin e dëmeve dhe kërcënimeve për natyrën;
- d) rikultivimin e peisazheve;
- e) ruajtjen e zonave të mbrojtura të natyrës dhe mbrojtjen e natyrës;
- f) nxitjen e metodave efikase për mbrojtjen dhe menaxhimin e natyrës;
- g) ngritjen e vetëdijes publike në lëmin e mbrojtjes dhe menaxhimit të natyrës;
- h) hulumtimet që lidhen me mbrojtjen e natyrës.

4. Mbështetur në të drejtën relevante të BE-së (Direktiva e propozuar mbi Përgjegjësinë Mjedisore), Qeveria mund të nxerr akte nënligjore për të vendosur përgjegjësi lidhur me pengimin apo rikthimin e dëmit tek llojet e rëndësishme apo habitatet natyrore.

Neni 40

Pronësia dhe kompensimet

1. Pronari i tokës brenda zonës së mbrojtur të natyrës është i detyruar të lejojë qasje në atë pjesë natyrore për përmbushjen e nevojave funksionale, shkencore, edukative, estetike dhe kulturore të shoqërisë. Këto aktivitete realizohen në pajtim me kushtet e përcaktuara me aktin me të cilin ai territor shpallet si zonë e mbrojtur e natyrës.

2. Nëqoftëse përdorimi i tokës apo i të mirave të natyrës në zonat e mbrojtura të natyrës është i kufizuar ose i ndaluar, pronari ka të drejtë kompensimi nga shkaku i kufizimeve dhe ndalimeve të vendosura. Qeveria përmes aktit nënligjor do të përcaktoj rregullat dhe procedurat që zbatohen për pagimin e kompensimit, përfshirë edhe kufizimet lidhur me mundësitë e kompensimit.

3. Kompensimet sigurohen nga buxheti i organit i cili ka vënë nën mbrojtje zonën.

XI. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 41

1. Personi juridik do të dënohet me gjobë në të holla prej 500-5.000 € nëse:

- a) keqëson gjendjen ekzistuese pas dërgimit të lajmërimit për shpalljen e territorit

- nën mbrojtje;
- b) thyen ndalimin e përcaktuar me aktin për shpalljen e territoreve natyrore nën mbrojtje, pa marrjen e lejes paraprake të ministrit;
 - c) harton planin ose projektin në kundërshtim me ndalimin të cilin e ka nxerrë ministri, me qëllim të mbrojtjes së peisazheve;
 - d) vepron në kundërshtim me aktet të cilat kanë të bëjnë me masat e veçanta të menaxhimit për territorret në mbrojtje natyrore (neni 29 paragrafi 1 dhe 2);
 - e) vepron në kundërshtim me ndalimet dhe kufizimet e përcaktuara me aktin e shpalljes së territorit si zonë të mbrojtjes së natyrës, pa lejen paraprake të ministrit (neni 32 paragrafi 1 dhe 2);
 - f) harton planin ose projektin i cili ka ndikim të dëmshëm në zonën e mbrojtjes së natyrës pa marrjen e lejes paraprake të ministrit (neni 32 paragrafi 1 dhe 2);
 - g) kryen punë të ndaluara në kundërshtim me nenin 12 paragrafi 2, 3 dhe nenin 33 paragrafi 1 dhe neni 34 paragrafi 1 pa marrjen e lejes paraprake të ministrit;
 - h) bën futjen (introduktionin) e llojeve, pa marrjen paraprake të lejes së ministrit;
 - i) bën futjen e sërishme të shtazëve të zhdukura, pa marrjen e lejes paraprake të ministrit;
 - j) nuk e lajmëron ministrinë për zbulimin e mineraleve dhe fosileve, në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj;
 - k) nuk ofron shitjen e mineraleve dhe fosileve, në mënyrën e përcaktuar me këtë ligj;
 - l) nuk siguron qasje në zonat e mbrojtura të natyrës në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
 - m) për kundravajtje nga paragrafi 1 i këtij neni gjobitet personi përgjegjës i personit juridik me gjobë të hollash prej 250-500 €

2. Personi fizik që kryen veprime nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet me gjobë në të holla prej 50-250 €.

3. Dënimet me të holla, paguhen në Fondin për mbrojtjen e mjedisit (Ekofond).

4. Korniza e gjobave do të operojë në mënyrë të pavarur nga çfarëdo përgjegjësie për pengimin apo restaurimin e dëmit të caktuar sipas nenit 38 paragrafi 3.

5. Ministri mund të nxjerr akt nënligjor për të ndryshuar apo rritur secilën nga kundërvajtjet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

XII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Dispozitat kalimtare

Neni 42

1. Planet për menaxhimin e zonave të mbrojtura, siç janë Parqet Kombëtare, të nxerrura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të aplikohen deri me skadimin e periudhës për të cilën janë nxerrë, nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Aktet e nxerrura për mbrojtjen e zonave të mbrojtura, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten në fuqi, kurse pronarët në zona, kanë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 43

1. Aktin sipas nenit 7 paragrafi 1 dhe 4 e nxerr Kuvendi i Kosovës në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

2. Akti sipas nenit 28 paragrafi 2 nxirret në afat prej dy vitesh pas shpalljes së zonës nën mbrojtje.

3. Aktet nënligjore sipas nenit 11 paragrafi 2, nenit 27 paragrafi 3 dhe nenit 13 paragrafi 1 do të nxirren brenda afatit prej 2 vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 44

Dispozitat subsidiare

1. Lidhur me çështjet proceduale sipas këtij ligji të cilat nuk janë rregulluar me këtë ligj, aplikohen dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të natyrës dhe vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut (GZK 39/88).

3. Procedura e filluar për mbrojtje sipas dispozitave të Ligjit për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave të natyrës dhe vlerave të krijuar me punë të ambientit të njeriut (GZK 39/88), do të vazhdojë dhe përfundojë sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 45

Hyrja në fuqi

Ky Ligj hyn në fuqi, pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës, nënshkrimit nga Kryetari i Kuvendit dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji nr.

Prishtinë, Qershor 2004

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Akademik Nexhat Daci